

Fjala e Guvernatorit

Në fund të gjashtëmujorit të parë, inflacioni është ulur dukshëm. Objektivi kryesor i Bankës së Shqipërisë për vitin 1999, tashmë duket i realizueshëm. Megjithë situatën e krijuar nga ashpërsimi i krizës Kosovare, pas fillimit të sulmeve të NATO-s mbi Jugosllavi, shoqëruar me një numër të madh të shpërngulurish me dhunë nga Kosova për në Shqipëri, gjatë gjashtëmujorit të parë u arrit :

- ulja e inflacionit në nivel vjetor nën zero (qershor'99/qershor'98), që ishte një nga faktorët kryesorë që ndikuan në uljen e nivelit minimal të normave të interesit për depozitat me afat deri në 13 për qind;
- rritja e rezervave ndërkombëtare të Bankës së Shqipërisë dhe mbiçmimi i lekut ndaj monedhave kryesore evropiane dhe dollarit amerikan;
- ruajtja e likuiditetit të sistemit bankar dhe realizimi i fazës së parë të privatizimit të Bankës Kombëtare Tregtare.

Vlen të theksohet se në ndryshim nga vitet e mëparshme, gjatë kesaj periudhe kemi pasur nivele më të ulëta të Indeksit të Çmimeve të Konsumit duke arritur në nivel vjetor, minus 0,6 pikë për qindjeje. Banka e Shqipërisë duke ndjekur situatën në rajon dhe likuiditetet e sistemit bankar, veproi me ulje të butë të normave të interesit në muajt maj, qershor, edhe pse kushtet për ulje ekzistonin që në muajin prill.

Ecuria e situatës monetare, që nga fillimi i vitit 1999, mund të ndahet në dy periudha. Në tremujorin e parë u vu re një përmirësim i ndjeshëm në të gjithë agregatët monetare, ndersa në tremujorin e dytë, situata në rajon dhe numri i rritur i popullsisë, çoi në rritjen e kërkesës për para CASH. Kështu:

- paraja jashtë bankave vazhdoi të ulet që nga fillimi i vitit duke arritur në nivelin më të ulët historik në fund të muajit mars 1999, por në fund të muajit qershor u kthye (sipas parashikimit) pothuaj në nivelin e fundit të vitit 1998;
- depozitat në lekë u rritën me ritme më të larta në tremujorin e parë në krahasim me të dytin, ndërkohë që depozitat në valutë ruajtën të njëjtat raporte ndaj depozitave në lekë. Kjo rritje e depozitave tregon se niveli i normave të interesit mbetet akoma tërheqës për publikun. Pas muajit mars 1999, ranë ritmet e rritjes së depozitave në lekë, dhe u rritën ato të depozitave në valutë (nga 31,63 % që zinin ndaj depozitave në lekë në fund të muajit mars, në 34,34 % në fund të muajit qershor). Kjo reflekton si kërkesën e rritur për lekë, ashtu dhe hyrjet e valutes për organizatat e ndryshme humanitare dhe joqeveritare të ndihmave;
- gjendja e kredive në bilancet e bankave u rrit me rreth 1,8 miliardë lekë në fund të muajit maj, një pjesë e së cilës është me fondet e të tretëve.

Rezerva valutore bruto ka pasur rritje gjatë kësaj periudhe, duke arritur në fund të muajit qershor në 435 milionë dollarë amerikanë, nga 375 milionë dollarë amerikanë që kërkon programi në fund të vitit 1999.

Kredia për ekonominë është dhënë nga bankat private shumë nën kufirin e shpërndarjes nga Banka e Shqipërisë. Banka e Shqipërisë, është shprehur edhe herë të tjera për zhvillimin e një sistemi bankar që mbështet shumë më fuqishëm zhvillimin e ekonomisë. Në miratimin e licencave për bankat private, jemi bazuar edhe në argumentimin e tyre për rritje të dukshme të aktivitetit kreditues. Mirëpo, akoma nuk mund të thuhet që bankat private janë ambicioze në këtë aktivitet, edhe pse kjo shprehet në kërkesat dhe premtimet e tyre të shpeshta. Kufiri i kreditit për ekonominë në dy vitet e fundit ka qenë aq i lartë, sa mund të thuhet se nuk është përdorur si instrument kufizues. Në të ardhmen e afërt, ky kufi kredie do të zëvendësohet nga rregullimet e mbikëqyrjes për likuiditetin, mjaftueshmërinë e kapitalit, klasifikimin e kredive, etj. Përfundimi sa më parë i regjistrimit të tokës bujqësore dhe lëshimit të çertifikatave të pronësisë për tokën - si mjet bazë për garancinë që shërben për mbështetjen e bujqësisë me kredi; miratimi i afërt i ligjit për transaksionet e siguruara (për barrët në veprimet financiare); si dhe forcimi i ndjeshëm i kërkesës së organeve tatimore për bilance reale të subjekteve tregëtare do të ishin elemente me ndikime jo të pakta në shtimin e aktivitetit kredidhënës nga bankat.

Numri i bankave të licencuara që veprojnë në Shqipëri arriti në dymbëdhjetë, mbas fillimit të aktivitetit të Bankës FEFAD dhe degës së Bankës së Parë të Investimeve. Kjo rritje e numrit të bankave, disa prej të cilave dhe me degë në rrethe të tjera të vendit do të çojë në shpërndarjen gjeografike të bankave, në rritjen e shërbimeve, mbështetjen e aktivitetit privat dhe në rritjen e konkurrencës në rrethe të tjera të vendit.

Janë bërë hapa të shumtë në drejtim të rritjes së bashkërendimit midis Bankës së Shqipërisë dhe Ministrisë së Financave, por akoma nuk është arritur niveli i duhur në procesin e parashikimit dhe të lidhjes reciproke të treguesve fiskale me ata monetarë. Kështu, nevojitet një Komitet Borxhi të Brendshëm, jo vetëm për diskutimin e problemeve aktuale apo të zgjidhjeve afatshkurtër, por edhe për prognoza, parashikime deri shumevjeçare, si dhe për prezantim të politikave fiskale dhe monetare të akorduara mirë. Banka e Shqipërisë, ka rishikuar rregulloret e tregut primar dhe sekondar të bonove të thesarit dhe të instrumenteve të kredisë së saj, me synim zhvillimin e tregjeve të parasë. Keto do të jenë baza më e rëndësishme për kalimin nga instrumentet direkte në ato indirekte të politikës monetare.

Banka e Shqipërisë, në zbatim të ligjit, paralajmëron periodikisht publikun për kërcënime të mundshme të sistemit financiar. Situata e ngarkuar me ngjarje në rajonin e Ballkanit dhe fluksi i madh i lëvizjes së refugjatëve nga Kosova në Shqipëri, në saje dhe të mbështetjes ndërkombëtare, mendojmë u përballua me sukses nga sistemi financiar aktual. Banka e Shqipërisë nuk del për këtë gjashtëmuor me një deklaratë të veçantë, por shpreh shqetësimin e saj për faktin se, megjithë kontestimin e saj për

disa ligje të vecanta që kanë të bëjnë me ecurinë dhe pjesëmarrësit e sistemit financiar, ende nuk është bërë përmirësimi i tyre.

Ekonominë shqiptare vazhdojnë ta mbajnë peng një varg çështjesh me pasoja edhe në politikën monetare, në planin afatshkurtër, por sidomos afatmesëm. Mbeten ende në rendin e ditës kërkesat për reforma thelbësore në vendosjen e rendit e të sigurisë, lufta kundër korrupsionit e kontrabandës, realizimi i investimeve publike, por sidomos nxitja e atyre private, shmangja e pothuaj monopolit në disa segmente të ekonomisë, si: bankare (Banka e Kursimeve), sigurimeve (INSIG), telekomunikacion (AlbTelekom, AMC), etj. Privatizimi i ekonomisë kërkon hapa të përsheptuar dhe konkrete, sipas rastit me nxitje e mbështetje edhe më serioze nga organizmat ndërkombëtare.

Gjashtëmujori i dytë i vitit 1999 është provë e rëndësishme për gjithë autoritetet shqiptare në arritjen e objektivave strukturore dhe sasiore të programit afatmesëm të mbështetur nga marrëveshja ESAF si parakusht për vazhdimin e mëtejshëm të programit dhe të realizimit të shumë premtimeve për mbështetjen e Shqipërisë me investime të vendit e të huaja. Arritja e objektivave për rritjen ekonomike, inflacionin dhe reformat do të jenë bazë për vitet e ardhme dhe duhet të konsiderohet si "provimi" për vazhdimin e mbështetjes së reformave në të ardhmen.

Me rezultatet e inflacionit në fund të gjashtëmujorit të parë, kemi sigurinë se inflacioni në fund të vitit do të arrihet diçka më poshtë se objektivi prej 7 për qind. Do të mbajme mbi kufirin e poshtëm rezervat valutore dhe në bashkëpunim me Ministrinë e Financave do të mbajmë nën kontroll kredinë e Bankës së Shqipërisë për Qeverinë. Kështu do të mund të përgatisim kushtet për përmirësimin e disa objektivave në vitin e ardhshëm. Këtu do të përmendim edhe një herë faktin për vështirësitë që has Banka e Shqipërisë në matjen e zhvillimit të ekonomisë. Në të ardhmen do të jetë shumë i rëndësishëm ky vlerësim pasi kërkesat ndaj sistemit bankar duhet të kenë si bazë reale zhvillimet e matshme ekonomike. Banka e Shqipërisë fton institucione të tjera për koordinim të punës në vlerësimin e të dhënave, duke përmendur rolin kryesor që duhet të marrë Instituti i Statistikave dhe puna e Komitetit Kombëtar të Statistikave.

Banka e Shqipërisë ka punuar gjatë kësaj periudhe për rritjen e transparencës së aktivitetit të saj. Këtij qëllimi i ka shërbyer rritja e numrit të botimeve dhe aksesit i lirë për këto jo vetëm nga shtypi, por për të gjithë përdoruesit e mundshëm. Gjithashtu, janë organizuar seminare për sistemin e pagesave, për politikën monetare dhe për tregjet e parasë, duke synuar prezantimin e platformës për përmirësim të mëtejshme në instrumentet e tjera të pagesave, metoda bashkëkohore për rritjen e komunikimit, përmirësimin e likuiditetit, minimizimin e riskut; u synua të prezantohej puna për hartimin dhe ndjekjen e programit të politikës monetare dhe ndryshimet në rregulloret e tregut të bonove të thesarit që do të jenë baza për zhvillimin e tregjeve të parasë dhe kalimin në instrumentet indirekte të politikës monetare. Në të ardhmen, në praktikën e Bankës së Shqipërisë do të shtohen forma të tjera të komunikimit me publikun për të bërë sa më të qarta synimet dhe politikat e ndjekura për arritjen e objektivit kryesor, kontributin në rritjen dhe përmirësimin e sistemit bankar dhe në mbështetjen e politikave të Qeverisë për rritjen e ekonomisë.

Shkëlqim CANI

Guvernator

I. Politika monetare e Bankës së Shqipërisë në 6-mujorin e parë të vitit 1999. Realizimi i objektivave sasiore në kuadrin e Marrëveshjes ESAF 2.

Banka e Shqipërisë edhe gjatë gjashtëmujorit të parë të vitit 1999 ka ndjekur një politikë të kujdesshme dhe relativisht të shtrenguar monetare për të ruajtur kontrollin mbi ofertën e parasë duke kontribuar në këtë mënyrë në arritjen e stabilitetit të çmimeve, si objektivi kryesor i saj.

Inflacioni, në nivel vjetor, nga 8.7 për qind që ishte në fund të vitit 1998, arriti në minus 0,6 për qind në fund të gjashtëmujorit të parë, në një kohë kur objektivi i inflacionit deri në fund të vitit është për një rritje prej 7 pikë për qind. Nisur nga niveli i ulët i inflacionit i arritur deri tani dhe nga parashikimi më i ulët se objektivi, Banka e Shqipërisë ka ulur nivelin minimal të interesit për të gjitha llojet e depozitave, tre here gjatë kesaj periudhe.

Së bashku me nivelin nominal të normave të interesit ka ardhur duke rënë edhe kursi i këmbimit të lekut në tregun valutor. Gjatë kësaj periudhe pothuajse ka ardhur duke u mbiçmuar si ndaj monedhave kryesore evropjane, ashtu edhe ndaj dollarit amerikan. Ndërhyrjet e Bankës së Shqipërisë në tregun valutor kanë qenë të papërfillshme.

Në kushtet e një situatë të vështirë të krijuar në vend, politika monetare e ndjekur gjatë kësaj periudhe ka synuar mbështetjen e aktivitetit ekonomik, uljen e deficitit buxhetor, dhe në të njëjtën kohë edhe ruajtjen e stabilitetit të sektorit të jashtëm të ekonomisë, pra në përgjithësi, ruajtjen e stabilitetit makroekonomik të vendit.

Situata e favorshme monetare, ulja e normave të interesit dhe mbiçmimi i lekut janë shoqëruar edhe nga një politike fiskale nën kontroll. Deficiti i përgjithshëm buxhetor në gjashtëmujorin e parë arriti në 21,6 miliardë lekë (ose 3,97 për qind e PPB-së), në krahasim me 48.1 miliardë lekë (ose 10,4 për qind e PPB-së) në fund të vitit 1998.

Banka e Shqipërisë gjatë këtij viti ka caktuar kufij më të larte krediti për bankat, për të nxitur nga njëra anë më shumë kreditimin e sektorit privat si dhe për të shmangur kosto artificiale në kredidhënie.

Në programin monetar të hartuar, nisur nga përcaktimi i objektivit vjetor të inflacionit dhe vlerësimet e pritshme të rritjes reale të ekonomisë, është përcaktuar që rritja vjetore e ofertës së parasë të jetë rreth 15 për qind. Sipas parashikimeve, deri në fund të muajit qershor 1999, paraja gjithsej është rritur 23 për qind me bazë vjetore (paraja gjithsej ka rritjen më të madhe në gjysmën e dytë të vitit, prandaj meqenëse baza qershorit 1998 është e ulët ky raport duket i lartë për fundin e muajit qershor 1999).

Për të siguruar një përputhje të kërkesës me ofertën për para, Banka e Shqipërisë ka përdorur kryesisht instrumentin e normës së interesit.

Në gjashtëmujorin e parë të vitit 1999, ka vazhduar monitorimi i objektivave sasiore të programit afatmesëm ESAF 2. Ecuria e këtyre objektivave në këtë gjashtëmujor, ashtu si dhe në periudhat e mëparshme, ka qenë brenda kufijve të përcaktuar në këtë program.

Rezervat Ndërkombëtare Neto gjatë gjashtëmujorit të parë të këtij viti kanë qenë shumë mbi kufirin e poshtëm që është caktuar për to. Në fund të muajit maj keto rezerva rezultuan rreth 71 milionë dollarë mbi objektivin e programit, ndërsa në qershor mbi 128 milione dollare. Rritja e tyre në tremujorin e parë ka ardhur nga 'tranche'-t e marra nga Komuniteti Evropian dhe Fondi Monetar Ndërkombëtar të planifikuara për këtë tremujor, ndërsa në muajt maj e qershor kjo rritje ka ardhur si rezultat i hyrjeve, nga donatorë të ndryshëm, teërreth 56 milione dollarë amerikanë për mbështetjen e deficitit të paparashikuar të buxhetit të këtij viti, nga shkak i krizës në Kosovë dhe i fluksit shumë të madh të të ardhurve në vendin tonë.

Mjetet e Brendshme Neto të Bankës së Shqipërisë, që përfaqësojnë diferencën e Bazës Monetare (Rezervës së Parasë) me Rezervat Ndërkombëtare Neto, gjatë gjashtëmujorit të parë kanë qenë në vazhdimësi poshtë kufirit të sipërm të vendosur për to. Në objektivat e programit ato nuk duhet të kalonin masën prej 71.5 miliardë lekë në fund të muajit qershor. Meqenëse, sipas të dhënave operative, për fundin e muajit qershor, këto mjete kanë arritur në 58.8 miliardë lekë (pra, janë zvogëluar me rreth 12.7 miliardë lekë nga ndarja e objektivit vjetor në gjashtëmujorë), mendojmë se do të jemi poshtë objektivit të caktuar edhe për periudhën në vazhdim.

Gjatë muajve të fundit të gjashtëmujorit të parë 1999, në dallim nga muajt e mëparshëm u vu re një tendencë e rritjes së Bazës Monetare, si rezultat i rritjes së Parasë Jashtë Bankave (një pjesë edhe për shkak të shtimit të popullsisë përdoruese). Kjo rritje është zbutur pjesërisht nga një rënie e rezervave të tepërta në lekë.

Rritja e Bazës Monetare në këtë periudhë është shkaktuar nga disa faktorë. Refugjatet e ardhur nga Kosova për të plotësuar nevojat e tyre personale kanë konvertuar valuta të ndryshme me lekë. Gjithashtu, organizatat e ndryshme humanitare dhe joqeveritare që erdhën në vend kishin përsëri nevojë për lekë në këmbim të valutave. Në të njëjtën kohë, edhe shpenzimet e Qeverisë u rriten më tepër nga sa ishin parashikuar për këtë periudhë me qëllim që të plotësoheshin nevojat imediate të refugjatëve dhe për të rritur shkallën e sigurisë së vendit.

Objektivi i Kredisë Neto të Sistemit Bankar për Qeverinë, ka, për fundin e muajit qershor 1999, si kufi të sipërm shumë prej 186.0 miliardë lekë. Deri në fund të tremujorit të parë, kredia neto për qeverinë ka rezultuar me rreth 5.7 miliardë lekë nën kufirin e sipërm të vendosur për të. Në muajin prill, për të plotësuar nevojat e buxhetit të shtetit, Banka e Shqipërisë ka blerë 2 miliardë leke bono thesari si kredi direkte për qeverinë, dhe si sistem bankar, pretendimet neto ndaj qeverisë, janë rritur me rreth 6 miliardë lekë, duke dhënë kontributin më të madh në rritjen e Parasë Gjithsej gjatë këtij muaji. Deficiti Buxhetor i financuar me burime të brendshme ka patur një rritje të shpejtë gjatë muajve prill-maj, por duke siguruar mbështetjen e mjaftueshme nga jashtë në financimin e shpenzimeve ekstra-buxhetore që kishin lidhje me refugjatët, mendojmë se për periudhën në vazhdim do të ketë një rritje normale.

Në muajin qershor, nuk u vu re ndonjë rritje e kërkesës së qeverisë për fonde nga Banka e Shqipërisë dhe sistemi bankar, si rezultat i hyrjeve të fondeve dhe granteve të ndryshme nga jashtë, të cilat e rritën gjendjen e depozitës së qeverisë në valutë.

II. Zhvillimet monetare, të kreditit, të kursit të këmbimit dhe të rezervave valutore.

Depozitat

Për këtë gjashtëmujor depozitat gjithsej (D) kanë vazhduar të rriten në sistem, duke zënë 72.4% të parasë gjithsej (M3) kundrejt 71.5% që zinin në fund të vitit 1998, ndërkohë që pjesa e parasë jashtë bankave ndaj parasë gjithsej është ulur në 27.6% nga 28.5% në dhjetor të vitit 1998. Ky fakt tregon se kontributi i depozitave në rritjen e parasë gjithsej ka qenë i konsiderueshem. Kjo duket edhe në raportin para jashtë bankave (PJB) me depozitat, i cili nga 39.91% në fund të vitit 1998 u ul në 38.06% në fund të qershorit, pavarësisht nga rritja që ka patur paraja jashtë bankave që nga muaji prill.

Depozitat gjithsej janë rritur 12.05% (të dhënat e qershorit janë operative) për gjashtëmujorin e parë të vitit 1999. Peshën kryesore në këtë rritje e kanë depozitat në valutë (DV) të cilat nga 23.52% të totalit të depozitave gjithsej që zinin në fund të vitit 1998 kanë arritur në 25.44% në qershor. Kurse, depozitat në lekë (DL) kanë rënë nga 76.48% në dhjetor 1998 në 74.56% në qershor 1999.

Në fund të gjashtëmujorit vihet re një tendence në rritje e depozitave në valutë, ndryshe nga viti 1998 kur keto depozita qëndruan pothuajse në vend. Kjo rritje e këtyre depozitave është në pjesën më të madhe në depozita pa afat në valutë, rreth 39.9%, dhe vetëm 2.4% në depozita me afat. Kjo, ka ardhur kryesisht nga rritja e fluksit të hyrjeve të valutave kryesore në vend gjatë krizës në Kosovë si nga vetë kosovarët ashtu edhe nga organizatat e ndryshme në vend. E vemë theksin, këtu pasi pjesa kryesore e rritjes është në depozita pa afat. Ndryshimet kryesore të agregatëve në tre periudha paraqiten si më poshtë:

(Raportet në pikë përqindjeje)

	Dhjetor 1998	Mars 1999	Qershor 1999*
PJB / M3	28.50	25.90	27.90
D / M3	71.50	74.10	72.10
PJB / D	39.91	35.01	38.78
DV / DL	30.75	31.92	34.47

* Parashikime në bazë të të dhënave operative.

Depozitat në lekë janë rritur me 9.2% për këtë gjashtëmujor dhe kontributin kryesor në këtë rritje e kanë depozitat me afat në lekë. Rritja mesatare mujore e tyre llogaritet rreth 2.0 miliardë lekë kundrejt rritjes mesatare mujore prej 3.7 miliardë lekë për vitin 1998. Kjo u influencua, përveç të tjerave, nga vlerësimi i lekut ndaj valutave kryesore në tregun e brendshëm valutator dhe nga kriza në rajon e cila krijoi, për momentin, pasiguri. Rritja e raportit të depozitave në valutë ndaj atyre në lekë, na le të kuptojmë se kërkesa relative për Lekun ka pësuar rritje.

Struktura e depozitave me afat në lekë paraqet tendenca të rritjes së peshës së depozitave me afat 12 mujor nga 38.65% në fund të vitit 1998 në 39.19% në fund të majit, kundrejt rënies së peshës specifike të depozitave me afat

tremujor nga 55.27% në fund të vitit 1998 në 53.94% në qershor, ndërkohë që ka patur një tendencë në rritje të peshës specifike të depozitave me afat gjashtëmujor, nga 5.52% në dhjetor 98 në 6.1 për qind në qershor 1999. Këto ndryshime në peshën specifike të depozitave me afat në lekë në favor të atyre me afat maturiteti më të lartë se sa tre muaj vlerësohen të jenë pozitive në përmirësimin e strukturës së likuiditetit të sistemit bankar.

Ndikimin kryesor në rritjen e depozitave në sistem, sipas sektoreve të ekonomisë, e zë sektori privat (rritja është 75.5% krahasuar me fundin e vitit 1998) dhe individet (rritja është 10.3% krahasuar me fundin e vitit 1999). Sektori privat rritjen e ka kryesisht në valutë, kurse individët e kanë kryesisht në lekë. Ndërmarrjet jofinanciare publike, për periudhën, paraqiten me rënie të lartë 49.2 për qind si në lekë ashtu edhe në valutë (te dhënat janë të muajit maj).

Paraja jashtë bankave vazhdoi të ulet që nga fillimi i vitit, duke arritur, siç u përmend më lart, në nivelin më të ulët historik në fund të muajit mars (shih tabelën më lart) pasi si shpenzimet buxhetore dhe krediti për ekonominë në këtë periudhë nuk janë rritur aq sa ishte parashikuar dhe, siç është vënë re në vitet e tjera, pas daljes së madhe të parasë në fund të vitit, vjen një kthim në sistemin bankar së bashku me një ngadalësim të aktivitetit ekonomik. Në ndryshim me vitet e mëparëshme, gjatë kësaj periudhe, kemi patur nivele shumë të ulëta të Indeksit të Çmimeve të Konsumit.

Situata e krijuar në rajonin e Ballkanit, me lëvizjet e mëdha të popullsisë kosovare në drejtim të Shqipërisë, u reflektua edhe në treguesit monetarë. Një numër më i madh i popullsisë do të shoqërohej nga një sasi më e madhe paraje për të përballuar nevojat e përditshme.

Në ndryshimet e raporteve pas muajit mars '99 mund të kenë ndikuar disa faktorë :

- përmendëm më sipër një numër më të madh të popullsisë që kërkon më shumë para në duar për nevojat e përditshme,
- u rritën shpenzimet buxhetore për të përballuar situatën e krijuar (përfshi, pritjen, shëndetësinë, mbrojtjen, transportimin, ndihmat ushqimore, etj),
- sasia e rritur e valutave që qarkullonin në vend nga të dy drejtimet kryesore: paratë që kishin me vete refugjatet kosovare dhe paratë që u sillnin të afërmit në perëndim; dhe fondet që vinin në drejtim të organizatave joqeveritare të ndihmave, organizatave ndërkombëtare humanitare dhe ushtarët e NATO-s,

- ulja e ritmit të depozitimit në lekë, sidomos në fillim të muajit prill për të përballuar shpenzimet e pritjes së refugjatëve në familje,
- kërkesat më të mëdha për mallra ushqimore duhet të kenë çuar në rritjen e aktivitetit tregtar.

Kreditimi i ekonomisë

Bankave private që zhvillojnë aktivitetin në Shqipëri iu njoftua një rritje e gjendjes së kredive në portofolet e tyre (kufi krediti) prej 3,6 miliardë lekë. Gjatë kësaj periudhe filluan aktivitetin e tyre Banka FEFAD dhe Banka e Parë e Investimeve. Institucioni FEFAD i shtoi portofolit të kredive të sistemit bankar aktivitetin e trashëguar prej rreth 700 milione leke. Në fund të muajit maj gjendja e kredive në sektorin privat të ekonomisë u rrit me rreth 3,2 miliardë lekë, por pas uljes së gjendjes në sektorin publik, sistemi bankar rezultoi me rritje të gjendjes për 1,8 miliardë lekë.

Bankat private gjatë kësaj periudhe kanë dhënë kredi jo vetëm me fondet e veta, por edhe me burime të të tretëve, si projekte të shteteve, organizmave ndërkombetare dhe bankave mëmë. Gjithashtu burim krediti janë dhe shlyerjet që gjatë pesëmuajorit arrijnë në rreth 2,2 miliardë lekë.

Situata në rajon dhe në vend nuk ka favorizuar mbështetjen e investimeve me kredi dhe bankat gjatë kësaj periudhe më shumë kanë studiuar praktika se sa kanë dhënë kredi. Kreditimi i kësaj periudhe ka mbështetur aktivitete të ndryshme tregëtie, agro-përpunimi, shërbimi turistik, restorante, riparim automobilash, etj. Në procesin kreditues bankat që kane të drejtë të japin kredi hasin në probleme që lidhen me: - faktin që biznesmenët i drejtohen bankës vetëm në raste kur kanë nevojë, pra kur kërkojnë hua, ndërkohë që si banka, ashtu edhe biznesmenët duhet të punojnë vazhdimisht me njeri –tjetrin; - dhe me vlerësimet paraprake që duhet të kenë pasuritë e vendosura si garanci, etj.

Banka e Shqipërisë për nxitjen e kreditimit dhe heqjen e kufizimeve nga përdorimi i instrumentit direkt të kufirit të kreditit ka miratuar përdorimin e kufirit të papërdorur të kreditit gjatë një tremujori, në periudhat pasardhëse dhe, siç u tha, ka synuar me politikën monetare në stabilitetin e çmimeve - bazë për uljen e interesave - dhe të kursit të këmbimit.

Normat e interesave për depozitat me afat në lekë.

Banka e Shqipërisë, në kushtet e mungesës së një tregu të zhvilluar të parasë, ka vepruar me normen e interesit si një instrument për arritjen ekuilibrit të ofertës dhe kërkesës së kursimeve në ekonominë kombëtare. Kjo për të

peëputhur në mënyrë sa më të natyrshme nga njëra anë, procesin e mobilizimit të burimeve financiare, absorbimin e kursimeve të reja, dhe nga ana tjetër, atë të shpërndarjes optimale të këtyre burimeve.

Gjithashtu, në këtë politikë, Banka e Shqipërisë, ka synuar të ndihmojë në kontrollin e nivelit të inflacionit për ta mbajtur atë në nivele sa më të ulëta të mundshme, duke i shërbyer objektivit kryesor të Bankës së Shqipërisë - arritjes dhe ruajtjes së stabilitetit të çmimeve të konsumit -, si dhe ndikimit që këto ulje japin në uljen e interesave për kredinë.

Gjatë gjashtëmujorit të parë të vitit 1999 niveli minimal i normave të interesave për depozitat në lekë është ulur tre herë. Nga niveli 16.5% për depozitat 12, 6 dhe 3 mujore që ishte në fund të vitit 1998 ato arritën në 13% për depozitat me afat 12 mujor dhe 13.5% për depozitat me afat 6 dhe 3 mujor në fund të qershorit 1999. Në këto ulje, Banka e Shqipërisë, ka marrë në analizë zhvillimet e treguesve më të rëndësishëm makroekonomikë dhe financiarë në vend, si dhe ndikimin që ato japin në arritjen e treguesve sasiore.

Shkurtimisht ndër më të rëndësishmit do të përmendim:

- tendenca e vazhdueshme në rënie e nivelit të inflacionit, i cili nga 8.7% në dhjetor të vitit 1998 arriti në nivel vjetor minus 0,6% në muajin qershor 1999 (ky indeks ishte -2.3% në raportin qershor/maj 1999). Si rrjedhim, niveli i normave reale mesatare të interesit për depozitat me afat në lekë qëndronte në kufij të lartë;
- ruajtja e stabilitetit të Lekut në tregun e brendshëm valutor. Leku është vlerësuar gjatë gjashtëmujorit të parë të vitit 1999 kundrejt dollarit me 1.3%, kundrejt markës me 10.3%, liretës 10.3% dhe dhrahmisë me 8.5%; Në keto kushte, nivelet nominale të interesave për depozitat në lekë kanë qenë shumë më të larta se sa niveli që ato duhet të kenë sipas parimit të barazisë së interesave të Lekut me atë të valutave kryesore.
- Rritja e depozitave në lekë dhe në valutë në sistemin bankar;
- ndikimi i faktorëve të tjerë psikologjike që nuk varen nga Banka e Shqipërisë.

Duke marrë në konsideratë zhvillimet në fund të muajit qershor, mbas fillimit të kthimit të shpejtë të kosovarëve në shtëpitë e tyre, Banka e Shqipërisë rishikoi edhe një herë normat e interesit të depozitave në lekë në fillim të muajit korrik, duke i ulur nivelet minimale në 11 për qind për depozitat me maturim dymbëdhjetëmujor dhe 11,5 për qind për maturimet tre dhe gjashtëëujore në

bankat shtetërore. Me këtë, veç të tjerash, synohet mbështetja e zhvillimeve të ekonomise në të ardhmen dhe rritja e peshës specifike të kreditit për ekonominë, në kredinë e brendshme.

Kursi i këmbimit të Lekut, niveli i Rezervës Valutore dhe operacionet e brendshme monetare.

Gjatë kësaj periudhe, Leku është forcuar në këmbimin e tij me valutat kryesore që tregtohen në tregun e brendshëm. Ky vlerësim ka qenë i qëndrueshëm kundrejt markës gjermane, liretës italiane dhe dhrahmisë greke, ndërkohë që kursi i këmbimit Lek/USD (dollar amerikan) ka paraqitur një volatilitet më të lartë.

Kursi i këmbimit Lek/USD është çelur në fillim të periudhës rreth nivelit 141.00 dhe ka qenë relativisht i qëndrueshëm deri në fund të muajit shkurt. Në fund të ketij muaji dhe për pjesën më të madhe të muajit mars, kursi i këmbimit Lek/USD është luhatur rreth nivelit 142.00, për t'u pasuar nga një rritje e menjëhershme në fund të muajit mars. Kjo periudhë korrespondon me fillimin e konfliktit në Kosovë dhe fushatën e bombardimeve të NATO-s. Situata e tensionuar rriti klimën e pasigurisë në vend dhe u shoqërua me pasoja konkrete në lidhjet e vendit me botën. Aeroporti i Rinasit ndërpreu përkohësisht fluturimet civile dhe vuri në vështirësi shumicën e bankave tregtare lidhur me furnizimin e tyre me valutë cash. Si rezultat kërkesa e shtuar për valutë thelloi diferencën me ofertën e reduktuar, dhe kursi i këmbimit të Lekut pësoi një zhvlerësim të shpejtë duke u ngjitur në këmbimin e tij me USD në nivelin 149.00. Që nga fillimi i vitit në vlerë nominale, ky zhvlerësim është në masën 5.37%. Vlen të theksohet se gjatë kësaj periudhe, Leku ndërpreu trendin e tij në rritje kundrejt valutave të dyta, dhe u zhvlerësua edhe kundrejt tyre. Kështu gjatë kësaj periudhe (muaji mars), Leku është zhvlerësuar nominalisht kundrejt markës gjermane me 4%, kundrejt liretës italiane me 3.9%, kundrejt dhrahmisë greke me 1.26%. Gjatë periudhës fund marsi-fillim prilli, Banka e Shqipërisë, me qëllim zbutjen e mungesës së likuiditetit në valutë cash të krijuar në tregun e brendshëm, ka shitur USD cash kundrejt llogarisë në sistemin bankar me qëllim plotesimin e nevojave të tij. Qëllimi ishte që situata e rënduar të mos shndërrohej në një panik tek depozituesit. Kjo lëvizje pati efektet e saj, dhe si rezultat kursi i këmbimit Lek/USD erdhi në rënie. Duhet theksuar, se kjo rënie, megjithë disa ndërprerje të lehta, ka qenë e qëndrueshme. Mendojmë se faktorët që ndikuan kanë qenë:

- një hyrje e konsiderueshme mallrash dhe valute, si rezultat i ardhjes së ndihmave nga organizatat e ndryshme ndërkombëtare dhe fondet e sjella

nga të larguarit me forcë nga Kosova. Pasoja ishte një rënie e kërkesës për mallra importi dhe shtim i drejtpërdrejtë i ofertës në valutë;

- një vazhdim i politikës së kujdesshme monetare të ndjekur nga Banka e Shqipërisë dhe operacioneve monetare të kryera me qëllim mbajtjen nën kontroll të situatës së likuiditetit të bankave dhe tregut financiar në përgjithësi. Ruajtja e niveleve relativisht të larta të normave reale të interesit, që shmangu efektet spekulative që mund të shkaktonte kjo situatë specifike;
- një politikë fiskale e kujdesshme;
- afrimi i një periudhe me efekte sezonale tradicionalisht pozitive për kursin e këmbimit të Lekut, e cila koincidoi me situatën sociale optimiste që krijoi rezultati i mbarimit të konfliktit;
- për një kohë të shkurtër, efekt mund të ketë patur pritshmëria e tregtarëve për hyrjen në fuqi të Kodit të Ri Doganor.

Në fund të qershorit 1999, kursi i këmbimit Lek/USD zbriti në nivelin 137.30, pasi kishte shënuar në fillim të muajit nivelin më të ulët që nga fillimi i vitit me 135.50. Që nga fillimi i vitit, Leku është vlerësuar nominalisht kundrejt USD në masën 2.62%.

Kursi i këmbimit Lek/DEM (markë gjermane) është çelur në fillim të vitit në nivelin 84.30, dhe është kuotuar në fund të muajit qershor 1999, në nivelin 72.90. Vlerësimi nominal i Lekut në këtë rast është në masën 13.5 % . Kundrejt ITL (lireta italiane), Leku është çelur në fillim të vitit në nivelin 84.80, dhe është mbyllur në fund të qershorit në nivelin 73.80. Vlerësimi nominal i Lekut në këtë rast është përsëri (të dyja monedhat konsiderohen EURO-cash) në nivelin 13 %. Kundrejt GRD (drahamisë greke), Leku është çelur në nivelin 49.50 dhe është mbyllur në fund të kësaj periudhe në nivelin 43.70. Vlerësimi nominal në këtë rast është në masën 11.72 %. Gjatë së njëjtës periudhë, monedha amerikane është forcuar (rreth 13 % me markën gjermane) në këmbimin e saj me këto valuta në tregun ndërkombëtar.

Gjatë gjashtëmuajorit të parë të vitit, vëllimi i përgjithshëm i transaksioneve (blerje + shitje) të këmbimit valutor në tregun e brendshëm, nga operatorët e tregut (banka + zyra të këmbimit valutor të licencuara), sipas të dhënave operative, ishte afërsisht 403.05 milionë USD. I njëjti tregues, në gjashtëmuajorin e dytë të vitit 1998, ishte 198.70 milionë USD. Vëllimi mesatar javor kapte shifrën 15.50 milionë USD. Vëllimi i raportuar nga bankat tregtare

është në nivelin 282.98 milionë USD, me një mesatare javore prej 10.88 milionë USD.

Banka e Shqipërisë ka qenë e pranishme në treg gjatë kësaj periudhe, në raste të rralla, duke patur kujdes që prania e saj të mos keqinterpretohet nga tregu. Duke patur një nivel të Rezervës Valutore mbi vlerat e domosdoshme, prania e saj në treg ka qenë kryesisht në shitje.

Rezerva Valutore Bruto e Bankës së Shqipërisë ka njohur rritje gjatë kësaj periudhe. Në fillim të vitit, niveli bruto i rezervës ishte në vlerën 384.22 milionë USD, ndërsa në datën 30.06.1999, ai ishte në nivelin 435.12 milionë USD. Rritja e vlerës së Rezervës është rreth 13.25% në vlerë relative. Disa nga hyrjet më të rëndësishme gjatë kësaj periudhe në Rezervën Valutore kanë qenë - granti i Komunitetit Evropian, - kreditë e IDA-s, - transhi i FMN,- Grant i Komunitetit Evropian.

Ndërsa në daljet më të mëdha mund të përmendim: - pagesat për borxhin e jashtëm, - shitje ndaj bankave, - transferim për llogari të Qeverisë.

Gjatë këtij gjashtëmujori, Banka e Shqipërisë ka filluar investimin e Rezervës sipas politikës së re të administrimit të rezervës valutore, miratuar nga Këshilli Mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë. Për herë të parë, sipas kësaj politike, lejohet investimi i Rezervës Valutore në bono thesari të Qeverisë Amerikane. Kjo rrit shkallën e diversifikimit të investimit të rezervës dhe shkallën e likuiditetit, duke ruajtur produktivitetin e dëshëruar nga investimi i saj.

Për periudhen në vazhdim, Leku do të vazhdojë të gjejë mbështetje nga zhvillimet sezonale të favorshme. Në vjeshtë dhe dimër, presioni mbi Lekun duhet të vijë në rritje, jo vetëm nga zhvillimet sezonale, por edhe nga ndryshimet që potencialisht mund të ndodhin nga levizja e mëtejshme e normave të interesit të Lekut. Megjithatë, pakësimi i rezervës për mbajtjen e saj në nivele të pranueshme, mund të keteëndikim të kundërt në kursin këmbimit të Lekut.

Përsa i takon nivelit të Rezervës valutore, Banka e Shqipërisë do të ndjekë një politikë të kujdesshme, e cila do të synojë kombinimin në menyrën më të mirë të mundshme, të sigurimit të stabilitetit të vlerës së Lekut dhe vlerës së kërkuar të nivelit të Rezervës valutore.

Gjatë të njëjtës periudhë, operacionet e Bankës së Shqipërisë në tregun sekondar të bonove të thesarit të Qeverisë së Republikës së Shqipërisë, përmes transaksioneve të riblerjes (ku Banka e Shqipërisë ishte në rolin e huamarrësit) kapnin shifrën 42.54 miliardë lekë. Veprimet më të mëdha janë

kryer me Bankën e Kursimeve dhe në shuma të vogla me bankat e tjera. Rastet e anasjellta (ku Banka e Shqipërisë është në rolin e huadhënësit) kanë qenë të rralla dhe në shuma të vogla. Në gjashtëmujorin e parë, Banka e Shqipërisë vetëm riinvestoi në ankandet e tregut primar të bonove të thesarit. Në fund të periudhës, portofoli i bonove të thesarit të blera në ankande nga Banka e Shqipërisë është 13.6 miliardë Lekë.

III. Objektivat për 6-mujorin e dytë të vitit 1999 dhe për të ardhmen.

Gjatë vitit 1999, si viti i dytë i programit, të mbështetur nga marrëveshja ESAF2, Banka e Shqipërisë do të vazhdojë monitorimin e programit mbi baza javore dhe mujore bazuar në kriteret sasiore dhe objektivat tregues të tij për fundin e muajit shtator-1999 dhe fundin e muajit mars-2000, si dhe duke u mbështetur në objektivat tregues për fundin e muajit qershor-1999 dhe dhjetor-1999 të vendosura mbi baza kumulative nga fundi i muajit dhjetor-1998.

Objektivi kryesor i Bankës së Shqipërisë në vitin 1999, për një rritje të inflacionit me 7 për qind, duket i arritshëm duke vlerësuar ndryshimin e Indeksit të Çmimeve të Konsumit në fund të gjashtëmujorit të parë të vitit 1999. Në përputhje me zhvillimet e inflacionit, kursit të këmbimit dhe faktorë të tjerë Banka e Shqipërisë do të synojë me politikën e saj monetare për të siguruar dhe garantuar rritjen e nevojshme të parasë për të mbështetur zhvillimin e ekonomisë, mbështetjen e projekteve publike e private dhe bilancin midis kursimeve dhe investimeve. Për këtë normat e interesit do të rishikohen në vazhdim dhe Këshilli Mbikqyrës i Bankës së Shqipërisë do të konsiderojë çdo muaj zhvillimet makroekonomike për të marrë vendime për nivelin minimal të interesave.

Këtë vit është parashikuar rritja e gjendjes së kredive në bilancet e bankave me 8 miliardë lekë. Duke marrë në konsideratë portofolin e kredive afatshkurtëra, shtrirjen e bankave private, projektet e huaja që ka sistemi bankar dhe që janë ofruar të vijnë në të ardhmen, bashkëpunimin e klientëve me bankat dhe probleme ligjore që hasin bankat në procesin e kredidhënies, mendojmë që nuk do të arrihet kjo rritje e portofolit të kredive me fondet e vete bankave. Për këtë arsye themi që instrumenti i kufirit të kreditit nuk mbetet më një 'tavan' për frenimin e rritjes. Nga ana tjetër Banka e Shqipërisë do të vazhdojë të mos lejojë të jepet kredi nga bankat që kanë kredi me probleme në më shumë se 20 për qind të portofolit të tyre. Për bankat shtetërore mendojmë se kjo është një siguri për tërheqjen e investitorëve strategjikë dhe për t'i mbrojtur në procesin e privatizimit.

Raportet e rezultuara midis agregatëve të parasë në fund të gjashtëmujorit të parë, janë një garanci për t'iu përmbajtur objektivave për rritjen e ofertës së parasë me 15 për qind në fund të vitit dhe për plotësimin e treguesve sasiore të programit afatmesëm: - Mjetet e Brendshme Neto të Bankes së Shqipërisë - Kredinë Neto të Sistemit Bankar për Qeverinë. Edhe niveli i Rezervës Valutore në fund të gjashtëmujorit na jep garanci të plote për plotësimin e objektivit për kufirin e poshtëm të saj në fund të vitit.

Banka e Shqipërisë, në kuadrin e kalimit në instrumentet indirekte të politikës monetare, do të rishikojë instrumentin e kufirit të kreditit. Puna për rritjen e aftësive mbikqyrëse ka vazhduar dhe, veç trainimit, janë rishikuar një sërë rregulloresh duke u bazuar në parime të njohura ndërkombëtare. Një hap vendimtar në këtë drejtim do të jetë privatizimi i bankave shtetërore, që mund të jetë parakusht për ndryshime në pozitat monopol të këtyre bankave. Tregu i parasë mund të zhvillohet midis pjesëmarrësve që janë në pozita tepër të diferencuara, dhe për këtë nuk është i mjaftueshëm vetëm përmirësimi i rregulloreve, por edhe konkurrenca midis tyre.

Banka e Shqipërisë do të punojë në zhvillimin e tregut të brendshëm të instrumenteve financiare duke përdorur marrëveshjet e riblerjes, veprimet e tregut të hapur dhe duke prezantuar ndryshime në rregulloret e tregjeve të bonove të thesarit. Këto zhvillime bëjnë pjesë në politikën dhe strategjinë e Bankës së Shqipërisë për të ardhmen.

Banka e Shqipërisë ka ndjekur zhvillimet në Kosovë dhe, në varësi të proceseve dhe zhvillimit të institucioneve financiare aty, do të vendosë lidhje me bankat dhe institucionet monetare duke ofruar kontributin dhe eksperiencën e saj në këtë drejtim.

IV. Përsëri për rreziqet e mundshme.

Banka e Shqipërisë ngre përsëri shqetësimin në lidhje me ato fenomene negative të cilat janë evidentuar dhe në deklaratat e mëparshme. Pa u ndalur edhe një herë në veçanti për çdo problem, Banka e Shqipërisë i kujton organeve ekzekutive se realizimi me sukses i programit afatmesëm do të mundësohet vetëm në rast të ndalimit një herë e përgjithmonë të fenomeneve negative që kanë të bëjnë me korrupsionin, kontrabandën, ekonominë informale, etj.

Gjithashtu, Banka e Shqipërisë tërheq vëmendjen për mënyren e rregullimit dhe të transferimit të kredive në Agjensinë e Trajtimit të Kredive, sidomos për

rastin e Bankës Kombëtare Tregëtare, bankë e cila është në proces të privatizimit.

Banka e Shqipërisë mendon se kalimi i të gjitha llojeve të kredive në ATK në mënyrën e përmendur në ligjin Nr.8339 datë 30.04.1998 "Për krijimin e Agjensisë së Trajtimit të Kredive", neni 11, krijojnë problem sepse :

ATK, në këtë ligj, vepron si agjente e bankave tregëtare me kapital tërësisht shtetëror, dhe se ajo do të ushtrojë funksionin e saj për një periudhë të shkurtër (deri në maj të vitit 2001), dhe kreditë e pashlyera, do t'i rikthehen bankës që e ka dhënë kredinë. Pra ndeshemi me kontradiktë midis përmbajtjes së ligjit dhe dhe faktit të moskthimit të kredive të BKT, sepse statusi i ri i BKT-së privatizuar kërkon që kjo bankë të jetë e çliruar nga të gjitha llojet e kredive.

Për zgjidhjen e kësaj kontradikte Banka e Shqipërisë mendon se është i nevojshëm një ndryshim i ligjit Nr.8339 datë 30.04.1998, lidhur me statusin e kësaj Agjensie dhe mënyrën e veprimit me kreditë e paarketuara nga BKT.

Tiranë, korrik 1999